



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:085373

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05741620

KPPP.nr. 1875/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Selmans Network” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810815061 dhe seli në Prishtinë, rr. “Jakov Xoxa”, Kompleksi Blini Co, p.n., kundër debitorit 1. N.N.SH “Korben” – R.K. B.I., me numër unik identifikues 811129726 dhe seli në Gjakovë, rr. “Nënë Tereza”, p.n., dhe 2. R.K., me adresë në Gjakovë, Guskë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorëve ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 19/23, i lejuar me datë 15.02.2023, nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorëve 1. N.N.SH “Korben” – R.K. B.I., me numër unik identifikues 811129726 dhe seli në Gjakovë dhe 2. R.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 19/23, i lejuar me datë 15.02.2023, nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 509/22, e datës 14.12.2022 dhe Faturës nr. 398/22, e datës 11.10.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 19/23, të datës 15.02.2023, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, në emër të përmbushjes së obligimeve sipas faturave të lartcekura t’ia paguajë kreditorit shumën prej EUR 16,996.80, me kamatë vonesë sipas ligjit, si dhe shpenzimet e procedurës që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitorët, brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se propozimi për përmbartim nuk i është dorëzuar me kohë nga ana e zyrtarit të PTK-së në Gjakovë dhe përmes pranimit të propozimit për përmbartim janë njoftuar edhe për bllokimin e xhirollogarive. Më tej, kanë theksuar se faturimi nga ana e debitorit është bërë për të gjitha mallrat dhe shërbimet të cilat ka qenë i obliguar t'i kryejë sipas porosisë dhe pas pranimit teknik të cilësisë së punëve dhe pajisjeve të bëhet pagesa e shumës së mbetur, andaj në rastin konkret propozimi i kreditorit është i parakohshëm. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se prapësimi i debitorëve është i pas afatshëm, duke qenë se i njëjti është dorëzuar pasi që urdhri përmbartimor është bërë i plotfuqishëm. Ka shtuar se pretendimi i debitorëve se shumica e punëve nuk janë kryer, është i pa bazuar, për faktin se pas përfundimit të punëve është bërë dorëzimi i faturave dhe të njëjtat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur. Tutje, ka shtuar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të dokumenteve, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm, sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorëve si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 509/22, e datës 14.12.2022 dhe Fatura nr. 398/22, e datës 11.10.2022, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha

elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në fatura, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorëve se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk janë të përshtatshme për përmbarim, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk përmbushin asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1875/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.